



Datë: 13.06.2025
Numër Protokolli: 4144/2025

A.nr.759/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.759/2025, të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 13.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.759/2025 e datës 29.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*) më datë 29.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2816/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.759/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.578/2025 të datës 14.04.2025, të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 29.04.2025 është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht i njëjti sipas Akt emërimit me shifër DRAPSH/ARC-2/13, të datës 31.01.2013, është i emëruar në pozitën e punës Zyrtar për Regjistrim në Qendrën Komunale për Regjistrimin e Automjeteve në Gjakovë.

Si rrjedhojë, ankuesi më datë 28.03.2025, i është drejtuar Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj z. B.C- Udhëheqës i ARC/MPB, si dhe nda z. M. Th- Drejtor i Drejtorisë për Pajisje me Dokumente ARC/MBP., mbi pretendimet për shkelje të rënda disiplinore, si keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, përmes Vendimit Nr.578/2025 të datës 14.04.2025, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e më sipërme të ankuesit për iniciimin e masës disiplinore për shkelje të rënda, me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore për të zhvilluar procedurë disiplinore, gjegjësisht nuk ka shkelje të rënda disiplinore, sipas nenit 56 paragrafit 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi Nr.578/2025 i datës 14.04.2025, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është nxjerrë mbi gjendje të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike, të qasjes së gabuar në paraqitjen e argumenteve të tij, pasaktësisë dhe devijimit të argumenteve, shkeljeve procedurale dhe animet subjektiv, duke kërkuar nga Këshilli anulimin e vendimit kontestues dhe urdhërimin e vazhdimin të procedurës disiplinore ndaj z. M.Th.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi përkatës i punësimit në rastin konkret, ankuesit nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, andaj i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.759/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.**

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.759/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.